



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201600595/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2016

**Lënda:** *Rekomandim për fillimin e hetimeve ndaj shtetasve Admir Goduni dhe Servet Daliu për veprën penale të "Kryerjes së veprimeve arbitrare", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 250 dhe 25 të Kodit Penal.*

**Drejtuar :** Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor  
Z. Petrit FUSHA

Tiranë

I nderuar zoti Fusha,

Në datën 26.03.2016, në orët e mbasdites, tek Parku i Liqenit Artificial të Tiranës u organizua një protestë nga drejtuesit e PD-së, mbështetës së saj dhe nga anëtarë të shoqërisë civile, të cilët janë kundër ndërtimit të këndit të lojrave në këtë park nga Bashkia Tiranë. Në orët e darkës të kësaj date, Institucioni i Avokatit të Popullit u njoftua nga disa aktivistë të shoqërisë civile të cilët protestojnë në mënyrë permanente në këtë vend, se një pjesëtare e tyre ishte dhunuar nga një punonjës i Bashkisë Tiranë.

Mbi bazën e kësaj ankese, Avokati i Popullit urdhëroi dy punonjës të këtij institucioni që të shkonin në vend dhe të bënin verifikimet përkatëse. Punonjësit e Institucionit të Avokatit të Popullit shkuan në vend dhe morën takim me disa përfaqësues të shoqërisë civile. Ata pretenduan se punonjësit e Policisë Bashkiake Tiranë u kishin prishur çadrën, të cilën e kishin vendosur pranë vendit ku po ndërtohet këndi i lojrave, ku mbanin disa materiale dhe qëndronin prej 11 ditësh pa ndërprerje. Gjithashtu ata pretenduan se, një kolege e tyre e quajtur R.C. ishte goditur me shqelm nga një person civil i cili ishte së bashku me policët e bashkisë. Sipas tyre, për shkak të goditjes ajo ishte ndjerë keq dhe ishte dërguar me autoambulancë në Spitalin Univeristar të Traumës Tiranë (Spitalin Ushtarak).

Avokati i Popullit së bashku me dy punonjësit e tij shkuan në Spitalin Univeristar të Traumës Tiranë dhe morën takim me shtetasen R.C., e cila ishte shtruar në repartin e urgjencës. Ajo u pyet rreth ngjarjes së ndodhur me të te vendi ku po ndërtohet këndi i lojrave në Parkun e Liqenit Artificial Tiranë.

Rreth orës 23:30 Avokati i Popullit u informua nga disa anëtarë të shoqërisë civile se, tre kolegë të tyre, të cilët protestojnë në mënyrë permanente tek vendi ku po ndërtohet këndi i lojrave, kishin shkuar në Komisarlatin e Policisë nr. 1 Tiranë për të bërë kallëzim ndaj punonjësve të Policisë Bashkiake Tiranë për dëmtimin e çadrës dhe dhunimin fizik të koleges së tyre, R.C.. Mirëpo atyre jo vetëm që nuk u ishte marrë kallëzimi, por ishin arrestuar nga punonjësit e këtij komisarati.

Bazuar në këtë informacion, Avokati i Popullit së bashku me dy punonjësit e tij shkuan në Komisarlatin e Policisë nr. 1 Tiranë dhe u takuan me njërin nga drejtuesit e këtij komisarati, shefin e seksionit nr.1 për krimet z. Julian Qyta dhe disa punonjës të tjerë të cilët ndodheshin aty duke punuar. Punonjësit e policisë na informuan se, tre personat në fjalë, të cilët quheshin A.M., L.V. dhe A.K. ishin shoqëruar nga agjentët e këtij komisarati sepse nga këqyrja e pamjeve filmike rezultonte që ishin pjesëmarrës në tubimin e paligjshëm dhe të dhunshëm të organizuar atë ditë tek Parku i Liqenit Artificial Tiranë. Meqënëse ishin persona të dyshuar si autorë të veprës penale ata ishin futur në dhomën e shoqërimit dhe mbaheshin të mbyllur me dryn. Nga Avokati i Popullit iu sugjerua punonjësve të policisë që të kryenin veprimet përkase me ta me objektivitet dhe duke respektuar të drejtat e tyre ligjore.

Avokati i Popullit dhe dy punonjësit e tij, para largimit nga komisarati morën takim me tre personat në fjalë A.M., L.V. dhe A.K., të cilët mbaheshin në dhomën e shoqërimit të këtij komisarati të mbyllur me dryn. Ata u pyetën rreth respektimit të drejtave të tyre dhe nëse kishin pretendime ndaj sjelljes së punonjësve të policisë me ta. Sipas tyre, në këtë komisarati ata kishin shkuar vetë, rreth orës 22:00 të datën 26.03.2016. Sapo kanë shkuar, në katin e parë, në hollin e godinës, kanë marrë takim me punonjës të informacionit të këtij komisarati, të cilit i kanë thënë për qëllimin e vajtjes në këtë komisarati. Ky qëllim ishte bërja e kallëzimit ndaj punonjësve të Policisë Bashkiake Tiranë për prishjen (dëmtimin) e çadrës së tyre dhe dhunimin fizik të shtetas R.C., e cila ndodhej e shtruar në Spitalin Universitar të Traumës Tiranë, si dhe për të kërkuar ndihmën e Policisë së Shtetit për tu qëndruar më afër tyre dhe mbrojtur nga Policia Bashkiake. Punonjësi i informacionit u ka thënë që të prisnin se do të takoheshin me shefin.

Pasi kanë pritur rreth një orë e 15 minuta dhe nuk i ka takuar asnjë drejtues apo punonjës tjetër policie, i kanë thënë punonjësit të informacionit se do të iknin dhe do të vinin të nesërmen për të bërë kallëzimin. Në këto momente aty ka ardhur një punonjës policie civil, i quajtur Admir Goduni, i cili pasi ka plotësuar nga një formular për secilin prej tyre u ka thënë se do të shoqëroheshin sepse pasi kanë parë pamjet filmike të protestës rezulton se ata janë pjesëmarrës në këtë protestë. Në këtë moment punonjësit e policisë i kanë futur ata të tre në dhomën e shoqërimit dhe i kanë mbyllur me zgarë hekuri dhe me dryn.

Meqënëse nga pyetja e tyre rezultoi se, ata të tre kishin ardhur vetë në këtë komisarati dhe nuk ishin shoqëruar sikurse informuan punonjësit e policisë, Avokati i Popullit dhe dy punonjësit e tij u kthyen për të sqaruar këtë çështje dhe pyetën me proceverbal personat që ishin futur në dhomën e shoqërimit dhe punonjësit e policisë që kishin marrë kontakt me ta.

Nga pyetja e punonjësit të policisë Gjovalin Frroku, i cili kryen detyrën e ndihmës specialistit të informacionit në këtë komisarati rezultoi se, ai kishte marrë takim me tre personat e cituar më sipër rreth orës 22:15 ose 22:20. Ata i

kishin thënë atij se kishin ardhur që të bënin kallëzim ndaj punonjësve të Policisë Bashkiake Tiranë për dëmtimin e çadrës së ngritur tek Parku i Liqenit Artificial dhe për dhunim fizik. Ai ka njoftuar shefin e seksionit nr. 1 për krimet z. Julian Qyta lidhur me këta persona dhe për arsyen e ardhjes së tyre. Ky i fundit i ka thënë atij se do të caktonte dikë që të punonte me ta. Në këto momente aty ka ardhur agjenti i policisë gjyqësore Admir Goduni, i cili i ka thënë atij se personat në fjalë kanë qënë pjesmarrës në protestë dhe ka përpiluar raporte shoqërimi lidhur me ata.

Mbasi punonjësi i policisë Admir Goduni i ka bërë raportet e shoqërimit, të dy së bashku i kanë futur shtetasit A.M., L.V. dhe A.K. në dhomën e shoqërimit. Rreth orës 00:37 ai i ka nxjerrë tre personat nga dhoma e shoqërimit dhe i ka çuar në zyrën e OPGJ Gazmir Sokoli, i cili ishte i gatshëm atë ditë për të kryer veprime procedurale. Sipas punonjësit të policisë të informacionit, deri në orën 01:37 të datës 27.03.2016, atyre nuk iu është marrë kallëzimi që ata donin të bënin.

Ndërsa nga pyetja e punonjësit të policisë Admir Goduni rezultoi se, në datën 26.03.2016, rreth orës 23:00 ai ka qënë në komisariat për të analizuar ngjarjen e ndodhur tek Parku i Liqenit Artificial në Tiranë dhe evidentuar personat që kishin marrë pjesë në këtë protestë të dhunshme. Në katin e parë të godinës, te salla e informacionit të komisariatit ai ka parë tre persona, emrat e të cilëve dhe arsyen përse kishin ardhur në komisariat nuk i dinte. Sipas tij, ata ishin pjesmarrës në protestën e dhunshme që ishte zhvilluar tek Parku i Liqenit Artificial, ku u qëlluan me gurë dhe kapsolla punonjësit e policisë. Sapo ka parë këta persona ai ka njoftuar shefin e seksionit nr. 1 për krimet z. Julian Qyta. Ndërkohë së bashku me kolegun Servet Daliu kanë bërë raportet e shoqërimit të këtyre personave në polici dhe pas kësaj i kanë futur ata në dhomën e shoqërimit për hetime të mëtejshme rreth ngjarjes së ndodhur. Në këtë kohë ai ka mësuar edhe emrat e tyre.

Sjellim në vëmendje se, në bazë të nenit 6 pika 25 të ligjit nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit", *"Shoqërimi" është dërgimi i shtetasit në ambientet e policisë, në institucionet shëndetësore, në qendrat e rehabilitimit, te kujdestari ose personi përgjegjës, në institucionin urdhërdhënës ose në institucionet tjera me ose pa vullnetin e tij, sipas përcaktimeve të bëra në nenet 109 dhe 122, pika 1, të këtij ligji.*

Nga hetimi administrativ i kësaj ankese rezulton e provuar se, në rastin konkret, në fakt nuk është bërë shoqërimi i shtetasve A.M., L.V. dhe A.K., sepse ata janë paraqitur vetë në komisariat për të bërë kallëzim ndaj punonjësve të Policisë Bashkiake dhe kërkuar ndihmën e policisë për ti mbrojtur prej tyre. Meqënëse nuk është bërë shoqërimi i tyre nga punonjësit e policisë, nuk kishte asnjë arsye ligjore që të përpiloheshin raportet e shoqërimit nga punonjësit e policisë Admir Goduni dhe Servet Daliu.

Në rrethanat që ata janë paraqitur vetë në këtë komisariat dhe kanë kërkuar të bëjnë kallëzim ndaj punonjësve të Policisë Bashkiake për dëmtimin e çadrës dhe dhunimin fizik të koleges së tyre, oficeri i policisë gjyqësore i cili ishte i gatshëm, bazuar në nenin 283 dhe 303 të Kodit të Procedurës Penale ishte i detyruar që, pasi tu bënte me dije për përgjegjësinë penale që ata kishin nëse bënin kallëzim të rremë, tu merrte kallëzim me procesverbal atyre. Edhe nëse ata dyshoheshin se ishin autorë të protestës (tubimit) të dhunshëm, punonjësit e policisë pasi tu merrnin kallëzimin për të cilin kishin ardhur në

komisariat, kishin të drejtën ligjore të kryenin veprimet procedurale duke i pyetur si persona ndaj të cilëve zhvillohen hetime.

Përpilimi në mënyrë fiktive i raporteve të shoqërimit të tyre nga punonjësit e policisë Admir Goduni dhe Servet Daliu, i krijuan mundësinë punonjësit të policisë Gjovalin Frroku, i cili kryen detyrën e ndihmës specialistit të informacionit në këtë komisariat, që ti trajtonte ata si të shoqëruar duke i futur në dhomën e shoqërimit. Futja në këtë dhomë dhe mbyllja e tyre me dryn përbën privim lirie dhe shkelje të të drejtave të tyre të garantuara nga Kushtetuta dhe ligjet në fuqi. Sqarojmë se kjo situatë e cënimit të të drejtave të tyre mund të vazhdonte të rëndohej edhe më shumë deri në 10 orë, nëse nuk do të ishte i pranishëm dhe nuk do të ndërhynte Avokati i Popullit.

Sjellim në vëmendje se, në bazë të nenit 2 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, *Policia e Shtetit ka për mision ruajtjen e rendit e të sigurisë publike, ruajtjen e personaliteteve të larta shtetërore dhe objekteve të rëndësisë së veçantë, garantimin e zbatimit të ligjit, në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut.* Ndërsa në bazë të nenit 85/1 të këtij ligji, *punonjësi i policisë detyrohet të respektojë Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si dhe të mbrojë të drejtat e liritë e njeriut.*

Në rastin në shqyrtim, veprimet e punonjësve të policisë Admir Goduni dhe Servet Daliu, të cilët kryejë funksionin shtetëror, si punonjës të Policisë së Shtetit, përmbajnë elementët e veprës penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 250 dhe 25 të Kodit Penal. Këto veprime ata i kanë kryer gjatë ushtrimit të detyrës së tyre duke cënuar rëndë lirinë e shtetasve A.M., L.V. dhe A.K., të garantuar nga Kodi i Procedurës Penale dhe ligji nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”.

Gjithashtu, këto veprime çenojnë rëndë imazhin e Policisë së Shtetit dhe dëmtojnë e trondisin thellë besimin e publikut tek ky organ.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave të njeriut, nga administrata publike”,* dhe në nenin 21/ç të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, ku thuhet se: *“i rekomandon prokurorisë të fillojë hetime në qoftë se vëren se është konsumuar figura e një vepre penale”,*

### **REKOMANDOJMË:**

Fillimin e hetimeve ndaj shtetasve Admir Goduni dhe Servet Daliu, me detyrë ndihmës specialist për hetimin e krimeve në Komisaratin e Policisë nr. 1 Tiranë, për veprën penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare”, parashikuar nga nenet 250 dhe 25 të Kodit Penal.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi të na ktheni përgjigje brenda 30 ditëve konform nenit 22 të Ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Bashkëlidhur po ju dërgojmë në cilësinë e provave fotokopje të dokumentave të mëposhtme:

1. Procesverbali i pyetjes së shtetasit A.M., datë 27.03.2016.
2. Procesverbali i pyetjes së shtetasit L.V., datë 27.03.2016.

3. Procesverbali i pyetjes së shtetasit Gjovalin Frroku, datë 27.03.2016.
4. Procesverbali i pyetjes së shtetasit Admir Goduni, datë 27.03.2016.
5. Raporti i shoqërimit të shtetasit A.M, datë 26.03.2016.
6. Raporti i shoqërimit të shtetasit L.V., datë 26.03.2016.
7. Raporti i shoqërimit të shtetasit A.K., datë 26.03.2016.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**K O M I S I O N E R I**

**Arben SHKËMBI**